

Dokumentacioni i nevojshëm për subjektet e interesuar mund të tërhiqet: pranë Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve, në godinën e Bashkisë Peqin, nga e nesërmja e shpalljes së Njoftimit në Agjensinë e Prokurimit Publik, nga data 04.01.2021.

Dokumente me pagesë: Po Monedha 500 (pesëqind) lekë.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 15.01.2021 ora 12.00.

BASHKIA KAVAJË
Njoftim për dhënien me qera

“Për dhënien me qira të pasurisë me nr. 57/2 vol. 8 faqe 97 në Z.K. 3101 Qerret, e llojit “pa frut”, me sipërfaqe 15400 m²”

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë

Adresa: Rruga “Josif Budo”, Ndërtesa Nr. 10,

Email: www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com

Tel: 055245555

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 15400 m² e pasurisë nr. 57/2, lloji pasurisë PF (pa frut), pasuri e cila është në pronësi të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë në vol. 8 faqe 97 ZK. 3101, me vendodhje në fshatin Qerret.

3. Qëllimi i dhënies me qira: Pasuria objekt i dhënies me qira do të jepet në zbatim të nenit 54/1 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe do të meren parasysh të gjitha kërkesat e Ligjit nr 93/2015 “Për turizmin”, kryesisht në fushën e turizmit për qëllime rekreative, pushimi etj, e cila do të gjenerojë të ardhura dhe do të nxisë punësimin.

4. Afati i dhenies me qira: 20 (vjet) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysHEME për detyrimin e qirase: 6000 (gjashtë mijë) lekë/ha në një vit kalendarik.

6. Konkurimi për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak me datë 07.01.2021 në orën 11:00.

7. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si më poshtë:

Niveli i investimit 40 pikë

Niveli i punësimit 30 pikë

Oferta e detyrimit mujor të qirasë 30 pikë

8. Subjektet konkurruese duhet të përcjellin dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesë e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore
- planbiznes të hollësishëm për vënien në funksion të objektit ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimit si dhe treguesit që do të realizohen
- ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë
- certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR

- NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore
- vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

9. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira”, dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

11. Data e zhvillimit të konkurrimit: në ambientet e Bashkisë Kavajë, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, me datë 07.01.2021 në orën 11:00.

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 07.01.2021, ora 11.00

BASHKIA TEPELENË **Njoftim për dhënien me qera**

Ne zbatim të VKM nr 54 date 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës së dhenies me qira, enfiëoze apo kontrata të tjera pasurisë shtetërore”, pika 3,4,6/b, me gjithë ndryshimet, Udhezimit nr 6756 date 03.09.2015 “Për zbatimin e VKM nr 54 date 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës së dhenies me qira, enfiëoze apo kontrata të tjera pasurisë shtetërore” VKB nr 76. date 27.11.2020 “Për miratimin në parim të dhenies me qira të pasurisë së sipërfaqe 270 (dyqind e shtatëdhjetë) m², të pasurisë me numër 13/51 vol 13 faqe 184; zonë kadastrale 3574;lloji truall .

NJOFTOJ:

- I. Fillimin e procedurave të dhenies me qira me anë të konkurrimit të pasurisë bashkise Tepelene,
me sipërfaqe 270 (dyqind e shtatëdhjetë) m², të pasurisë me numër 13/51 vol 13 faqe 184; zonë kadastrale 3574;lloji truall ..
- I. Qellimi i përdorimit do të jetë për zhvillimin e ekonomisë, ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, të cilat gjenerojnë të ardhura për shoqërinë dhe nxisin rritjen e punësimit dhe investimit
Cmimi dysHEME do të jetë 12 leke/m², e detajuar sipas sipërfaqeve :
270m² x12 l/m² =3240 leke /muaj
- II. Afati i kontratës së qerës është 10 vjet.
- III. Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas ketyre pikave:
Niveli i Investimit 40 pike
Niveli i Punësimit 40 pike
Oferta mujore e qirës 20 pike
- IV. Konkurrimi do të bëhet në datë me datë 17.01.2021., ora 9 00 në zyrën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Tepelene, që është dhe afati i fundit i dorëzimit të ofertave.